




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME DHE FINANCËS

Nr. 857/prot.
2

Tiranë më 30.5.2018

Lënda: Dërgohet propozimi për një ndryshim në Strukturën dhe Organikën e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

KUVENDIT TË SHQIPËRISË

**KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE
TË DREJTAT E NJERIUT**

Tiranë

Me Ligjin nr. 109/2017 "Për Buxhetin e vitit 2018", Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale i është miratuar numri total prej 37 punonjësish, krahasuar me 35 që është aktualisht.

Bazuar në Ligjin 9584, datë 17.7.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj", i ndryshuar, Zyra e Komisionerit paraqet për miratim propozimin për të reflektuar ndryshimet në Strukturën dhe Organikën e saj, miratuar me Vendimin nr.106/2014, datë 18.12.2014, të Kuvendit të Shqipërisë.

Të dy punonjësit do të shtohen në strukturën që mbulon të drejtën e informimit, pasi që me krijimin e saj me ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", nuk ka qenë e plotësuar me numrin e nevojshëm të punonjësve.


Struktura e propozuar parashikon që kjo drejtori të ketë në përbërje të saj 6 (gjashtë) nëpunës, 1 (një) drejtor dhe 5 (pesë) inspektorë, të cilat paraqiten në Strukturën dhe Organikën, sipas emërtesave përkatëse dhe kategorinë e pagës sipas VKM nr. 187, datë 8.3.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë...", lidhja nr. 3, pozicionet e veçanta, të cilën e gjeni bashkëlidhur.

Zyra e Komisionerit, ka marrë në konsideratë sugjerimet e Departamentit të Administratës Publike, lidhur me propozimin e dërguar për ndryshimet në strukturën dhe organikën e saj. Ndërsa është siguruar elektronikisht dakordësia e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në pritje të shkresës zyrtare. Bashkëlidhur gjeni korrespondencat me institucionet e përmendura më sipër.

Me ligjin nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, janë akorduar fondet “Shpenzime të Personelit”, për numrin e miratuar (37) të punonjësve e për pasojë ndryshimi i strukturës nuk prodhon efekte financiare shtesë

Duke ju falenderuar,


KOMISIONERI
Besnik Dervishi



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

STRUKTURA ORGANIZATIVE

LIDHJA Nr.1



Varianti i propozuar

Lidhja nr. 2

**ORGANIKA DHE KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS TË ZYRËS SË
KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

Funksioni	Nr. i punonjësve	Kategoria/Klasa
I. Komisioneri	1	D Ligji nr. 9584, datë 17.07.2006, i ndryshuar
II. Kabineti		VKM. 187, datë 8.3.2017
Këshilltar	1	II – b
Sekretar	1	
III. Drejtoria për të Drejtën e Informimit		
Drejtor	1	II – b
Inspektor	5	III - a
IV. Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale		
Drejtor	1	II – b
Inspektor	4	III - a
V. Drejtoria e Hetimit Administrativ		
Drejtor	1	II – b
Inspektor	4	III - a
VI. Drejtoria e Çështjeve Juridike		
Drejtor	1	II – b
VI/I Sektori i Legjilsacionit		
Shef sektori	1	III - a
Specialistë	2	III - b

VI/II Sektori i Procedurave Administrative

Specialistë	2	III - b
-------------	---	---------

VII. Drejtoria e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Drejtor	1	II – b
---------	---	--------

VII/I .Sektor i Komunikimit me Median dhe Publikun

Specialistë	2	III - b
-------------	---	---------

VII/II. Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve

Shef sektori	1	III - a
--------------	---	---------

Specialist	2	III - b
------------	---	---------

VIII. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës

Drejtor	1	II – b
---------	---	--------

Specialist i burimeve njerëzore/ analist i punës	1	III – b
---	---	---------

Specialist IT	1	III –b
---------------	---	--------

Specialist buxhet/financë shërbime	1	III - b
------------------------------------	---	---------

Specialist redaktor/protokoll/arkiv	1	IV-a
-------------------------------------	---	------

Shofer	1	Kl. IV (VKM nr.717, datë 23.06.2009, i ndryshuar)
--------	---	---

Gjithsej	37 punonjës	
----------	-------------	--



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME DHE FINANCËS

Nr. 857 prot.

Tiranë më 12.5.2018

Lënda: Dërgohet për mendim propozimi për një ndryshim në Strukturën dhe Organikën e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

MINISTRISË SË FINANCEVE DHE EKONOMISË

DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Tiranë

Me Ligjin nr. 109/2017 "Për Buxhetin e vitit 2018", Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale i është miratuar numri total prej 37 punonjësish, krahasuar me 35 që është aktualisht.

Bazuar në ligjin 9584/2006, datë 17.7.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj", i ndryshuar, Zyra e Komisionerit do të paraqesë propozimin pranë Kuvendit të Shqipërisë për të reflektuar shtesën në Strukturën dhe Organikën e saj.

Të dy punonjësit do të shtohen në strukturën që mbulon të drejtën e informimit. Kjo strukturë që me krijimin e saj në zbatim të Ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", nuk ka qënë e plotësuar me numrin e nevojshëm të punonjësve.



Struktura e propozuar parashikon që Drejtoria për të Drejtën e Informimit të ketë në përbërje të saj 6 (gjashtë) punonjës, 1 (një) drejtor dhe 5 (pesë) inspektorë.


Bashkëlidhur gjeni Strukturën dhe Organikën, sipas emërtesave përkatëse dhe kategorinë e pagës, bazuar në V.K.M nr. 187, datë 8.3.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë...", lidhja nr. 3, pozicionet e veçanta.

Me Ligjin nr. 109/2017 "Për buxhetin e vitit 2018", janë akorduar fondet "Shpenzime të Personelit", për numrin e miratuar (37) të punonjësve, e për pasojë ndryshimi nuk sjell efekte financiare shtesë.

Do t'ju luteshim një përgjigje tuajën sa më të shpejtë.

KOMISIONERI
Besnik Dervishi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

Nr. 3413 / prot.

Tiranë, më 14 . 05 . 2018

Lënda: Kthim përgjigje

**KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

Tiranë


Në përgjigje Tuajës nr. 857, datë 10.5.2018, me subjekt "Dërgohet për mendim propozimi për një ndryshim në strukturën dhe organikën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Departamenti i Administratës Publike, pas shqyrtimit me vëmendje të propozimit, shprehet në parim dakort me ndryshimet e propozuara.

Ndërkohë, sugjerojmë që pozicioni "specialist protokoll-arkiv", në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, që propozohet të jetë në kategorinë IV-a, duhet të mbetet në kategorinë IV-b, sikurse është aktualisht, në respektim të standardeve të njëjta me institucionet analoge.

Duke Ju falenderuar,

DREJTOR DEPARTAMENTI

Albana Ruzh





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT DHE BORXHIT
DREJTORIA E ANALIZAVE DHE PROGRAMIMIT BUXHETOR**

Nr. 9364 Prot.

Tiranë, më 30/05/2018

Lënda: Mbi strukturën dhe organikën e Komisionerit për të drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

**KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Nd. 5, Tiranë

Për Dijeni: **DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE**

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

Në vijim të shkresës suaj nr.857prot., datë 10.05.2018, nëpërmjet të cilës dërgohet për mendim propozimi për një ndryshim në strukturën dhe organikën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, parë në këndvështrimin buxhetor, shprehemi parimisht dakord me projektin e propozuar për sa kohë ndryshimi i propozuar është brenda buxhetit dhe numrit të miratuar në ligjin nr. 109/2017 "Për buxhetin e vitit 2018" për Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Me respekt,

MINISTER

Arben Ahmetaj